



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401174/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandim nga Inspektimi i kryer në Shtëpinë e të Moshuarve, Tiranë.*

Drejtuar: Drejtoreshës së Shërbimit Social Shtetëror
Znj. Etleva BISHA

TIRANË

Për dijeni: Drejtorit të Shtëpisë së të Moshuarve
Z. Ramazan GJUZI

TIRANË

E nderuara znj. BISHA,

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave të njeriut, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 05.06.2014, vijuan inspektimin e radhës në Shtëpinë e të Moshuarve, Tiranë.

Qëllimi i këtij inspektimi ishte zbatimi i rekomandimeve të dërguara nga inspektimi i kryer në muajin Tetor 2013, ku pas problemeve të konstatuara, ju jemi drejtuar me rekomandim për marrjen e masave *për shtimin në organikë me një psikiatër, një shofer, dy guzhiniere dhe një mirëmbajtës me qëllim plotësimin në vazhdimësi të standarteve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit*

Në takimin e bërë me drejtorin e kësaj qendre, u informuam se nga rekomandimet e sipercituara është zbatuar shtimi vetëm me një kuzhinier. Nuk janë janë realizuar ende shtimi në organikë me një psikiatër, një shofer dhe një mirëmbajtës.

Nga ana e drejtuesit të qendrës u informuam se ju ishte premtuar se në muajin Korrik-Gusht të vitit 2014 do të ketë shtesë me një shofer dhe mirëmbajtës.

Duke qenë se të moshuarit që strehohen në qendër kanë nevojë për shërbime të ndryshme jo vetëm spitalore, është e nevojshme edhe pasja e një mikrobuzi.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, si dhe ne baze të nenit 21/b të Ligjit nr.8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se : *“Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për shtimin në organikë me:

1. një psikiatër,
2. një shofer,
3. një mirëmbajtës .

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se:

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Me respekt

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI